



Nr. 100/24  
Prishtinë, më 20.11.2024

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 26, nenit 27, nenit 29, nenit 35, nenit 36 paragrafi 6, neni 39, si dhe neni 55 paragrafi 2 me nën paragrafin 2.4, i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Udhëzimin Administrativ nr. 08/2023 për Përcaktimin e Keqpërdorimit të Pozitës Dominuese, bazuar në propozim/kërkesën e parashtruar nga ndërmarrja Enter Air Sp.z.o.o, ( The Enter Air Airline) me adresë: ul. Komitetu Obrony Robotikow 74, 02-146 Warsaw, përmes Avokatit Xhafer Tahiri nga Prishtina, përfaqësues i autorizuar i palës ankuese, kundër Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës dhe ndërmarrjes GP Aviation, në mbledhjen e mbajtur me datën 20.11.2024 merr këtë:

## KONKLUZION

Autoriteti gjatë shqyrtimit paraprak, konstaton se nuk ka kushte për fillimin e Procedurës Hetimore ndaj Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës dhe ndërmarrjes GP Aviation, sipas nenit 36 paragrafi 6 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

## A r s y e t i m

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, me datën 22.05.2024, me Nr. Prot. 321/24-D/H, ka pranuar propozim nga ndërmarrja Enter Air Sp.z.o.o, ( The Enter Air Airline) me adresë: ul. Komitetu Obrony Robotikow 74, 02-146 Warsaw, Poloni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokatit Xhafer Tahiri nga Prishtina, kundër Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës dhe ndërmarrjes GP Aviation, për shkak të mundësimit të pozitës dominuese në tregun e fluturimeve ajrore për dhe nga konfederata e Zvicrës.

### Pretendimet e paraqitësit të iniciativës:

Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës ka shpallur një tender për caktimin e një linje ajrore mes Kosovës dhe Zvicrës, me datë 11.03.2024, përmes vendimit të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, nr. 05/ZDP/VE/2024.

Tenderi nuk është komunikuar publikisht tek asnjë linjë ajrore ose i dërguar/designator. Tenderi është publikuar vetëm në faqen zyrtare të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

LIGJI NR. 03/L-051, PËR AVIACIONIN CIVIL, në asnjë dispozitë të tij, nuk e autorizon Autoritetin e Aviacionit Civil të shpallë thirrje të tillë e as të vendos kritere siç ka vepruar Autoriteti Aviacionit Civil të Kosovës në këtë rast.

Me datë 24.04.2024, Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës ka shpallur fitues të këtij tenderi kompaninë: GP "Aviation" sh.pk., me AOC Nr. BG65 dhe me Certifikatë të Regjistrimit të Degës në

U.P.B.!

Sed

Kosovë nr. 811882217, ku kjo kompani ËSHTË PËRCAKTUAR/Designuar për të ushtruar të drejtat e trafikut ajror, për dhe nga Konfederata e Zvicrës, për një periudhë tre (3) vjeçare, nga dita e fillimit të shërbimeve të rregullta ajrore.

Megjithatë, thirrja publike/tenderi ishte shumë specifik, ku e kufizon konkurrencën dhe e forcon pozitën dominuese të një kompanie (në këtë rast GP Aviation) ku më poshtë po i përshkruajmë disa pika të këtij tenderi që në pikëpamjen e iniciuesit të kësaj kërkesë ja mundësuan GP Aviation pozitën dominuese në tregun e fluturimeve ajrore për dhe nga Konfederata e Zvicrës.

Për më tepër këto pika që ishin kushte të tenderit sipas pikëpamjes sonë kanë kuptim vetëm nëse fituesi i këtij tenderi është caktuar që më pare.

Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës ka vendosur këto kushte si më poshtë në tenderin e datës 11.03.2024, e të cilat në pikëpamjen tonë, kufizojnë konkurrencën e lirë, e i japin pozitë dominuese në treg GP Aviation dhe rrjedhimisht shkelin konkurrencën e lirë dhe i shkelin dispozitat e LIGJIT Nr. 08/L-056 PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS.

1. Tenderi i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës ka paraparë një afat shumë të shkurtër për paraqitjen e ofertave (pika 25.3.) dhe fillimin e operacioneve (pika 1.6.), duke bërë që pikërisht pika 1.1 e tenderit të bëhet absurde, pasi është kërkuar regjistrimi i një firme në Kosovë si kusht paraprak. Është faktikisht e pamundur për një linjë ajrore serioze të marrë një vendim për të marrë pjesë në tender brenda dy javëve, të ndryshojë orarin e fluturimeve për verën e 2024, të stacionojë avionët në Prishtinë dhe njëkohësisht të bëjë regjistrimin e firmës në Kosovë për të paraqitur të gjitha dokumentet në kohë tek Autoriteti i Aviacionit Civil.
2. Është kërkuar që aktiviteti kryesor i linjës ajrore të jetë në vendin ku është lëshuar AOC (Certifikata e Operatorit Ajror). Në rastin konkret, kjo është Bullgaria për GP-Aviation. Megjithatë, GP-Aviation nuk shërben asnjë rrugë ajrore nga dhe në Bullgari, por ekskluzivisht operon si charter I plotë nga dhe për në Kosovë (përveç Bullgarisë).
3. Të gjitha linjat ajrore aktuale janë përjashtuar nga tenderi që kanë një partneritet ose janë në pronësi të plotë ose pjesërisht të një linje ajrore që ka të drejtat për rrugët ajrore midis Zvicrës dhe Kosovës. Kjo do të thotë që të gjitha linjat ajrore zvicerane janë të përjashtuara.
4. Është kërkuar që për kryerjen e operacioneve ajrore të jenë të nevojshme të paktën 3 avionë. GP-Aviation ka vetëm një avion të regjistruar në AOC.
5. Në tender/thirrje publike është kërkuar dhe është vënë kusht për dhënie të tenderit që linja ajrore konkurruese të ketë transportuar të paktën 100,000 pasagjerë nga Prishtina në vitin e kaluar pra në vitin 2023; duke diskualifikuar kështu të gjitha linjat ajrore të reja dhe të njohura që operojnë në Kosovë. Numri prej 100,000 pasagjerëve është plotësisht arbitrar dhe ka vetëm një qëllim: diskualifikimin e kompanive ajrore të cilat janë të interesuara për një dezignim për linjën ajrore për dhe nga Konfederata Zvicerrane.
6. Sipas Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, tenderi ka për qëllim thyerjen e "pozitës monopolistike". Por është fakt i njohur e publik që vetëm GP Aviation kalon numrin prej 100,000 pasagjerëve në vitin 2023, dhe Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës e dinte që më parë këtë fakt sepse i menaxhon këto të dhëna. Tani që kjo kompani është shpallur fituese e tenderit, pozita e saj dominuese në treg të fluturimeve për dhe nga Konfederata Zvicerrane bëhet edhe me e kuartë dhe më e fuqishme.
7. Është kërkuar që linja ajrore të ketë shitjet direktet. GP-Aviation deri më tani nuk ka asnjë faqe zyrtare në internet (këtë mund të verifikoj vet Autoriteti i Konkurrencës) dhe kështu nuk ka një makinë rezervimesh të biletave. Ashtu siç u përmend më lart, GP-Aviation operon si fullcharter.
8. Por pasi GP-Aviation tashmë ofron rrugën midis Baselit dhe Prishtinës deri në 14 herë në javë, pika 3.3 e tenderit bëhet e pakuptimt madje absurde. Bazel, vendi me frekuenca më të larta nga Zvicra, nuk përjeton një ofrues të ri, por krijon madje hapësire për një reduktim të fluturime në përputhje me tenderin në të paktën 10 fluturime në javë. Kjo do të përforcojë edhe më shumë "pozitën dominuese" të GP Aviation.

9. Me tender/thirrje publike është kërkuar që përmbushja e fluturimeve të përmendura në pikat 3.1. deri në 3.4. të mos jetë më pak se 90%, e cila është krejtësisht jashtë realitetit. Ky kusht është kundër rregullave të tregut të lirë. Është tregu i lirë që e përcakton shitjen e biletave të linjave ajrore sipas zgjedhjes së lirë të konsumatorëve. Duke qenë se Autoriteti i Aviacionit Civil i njeh rregullat e tregut të lirë, është e qartë që çmimet e biletave orientohen sipas ofertës dhe kërkesës. Kushti për të operuar këto fluturime me një shkallë mbushjeje të avionëve prej të paktën 90% është në kundërshtim me të gjithë faktorët ekonomike të tregut të lirë e që në këtë rast për të përmbushur këtë kusht, duhet të neglizhohen. Një linjë ajrore është efektivash e detyruar të operojë pa qenë profitabile.
10. Të gjitha këto kushte tenderuese dhe zgjedhja e GP aviation si fituese e këtij tenderi shkelin Nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-056 PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS. Për shkak të këtyre kushteve të tenderit, inicuesit të kësaj kërkesë i është pamundësuar të marr pjesë në këtë tender të Autoritetit & Aviacionit Civil të Kosovës.
- Prandaj në pikëpamjen e inicuesit të kësaj kërkesë, fakteve të elaboruara si më lartë, pikat e përmendura më lartë janë të gjitha antikompetitive e kufizojnë konkurrencën e lirë, fuqizojnë në realitet pozitën dominuese në treg të GP Aviation prandaj i tërë tenderi dhe kushtet në të ishin krijuar vetëm për një linjë ajrore, në veçanti GP-Aviation nga Bullgaria duke eliminuar mundësinë që aviokompanitë tjera të marrin pjesë në këtë tender.

### **Përshkrimi i Gjendjes nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës**

Me datën 18.07.2024, përfaqësuesit e Autoritetit të Konkurrencës kanë zhvilluar takim në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, të cilët kanë deklaruar se:

Emërimit (dezignimi) i operatorëve ajror për ofrimin e shërbimeve ajrore, Emërimi siç njihet edhe me termin “Dezignimi” (eng. Designation) është proces i dhënies së autorizimit për operatorë ajror për shfrytëzim të të drejtave të fluturimit mes dy vendeve bazuar në marrëveshjen bilaterale për Shërbime Ajrore të shteteve nënshkruese si dhe rregulloret dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare. Procesi i dezignimit bëhet për të siguruar shërbime të mira të transportit ajror me çmime konkurente dhe të arsyeshme për publikun nga një operator ajror i huaj që ka qëndrueshmëri operacionale dhe financiare, gjithnjë duke mbrojtur interesin e publikut dhe atë shtetëror si dhe me synim që të kufizohet monopoli në treg.

Zakonisht shtetet dezignojnë kompaninë e tyre flamurtare (flag carrier) dhe pastaj sipas nevojës së tregut nëse lejohet dezignim i shumëfishtë edhe i kompanive të tjera të huaja kjo bëhet në marrëveshje me shtetin tjetër gjithnjë duke ju përmbajtur parimit të interesit të publikut dhe atë të reciprocitetit.

Kosova, në mungesë të një kompanie ajrore vendëse mundësinë e vetme për momentin e ka dezignimin e një operatori ajror të huaj për ofrimin e shërbimeve ajrore sipas kushteve që me marrëveshjet ajrore bilaterale apo multilaterale me shtetet e ndryshme.

Për Kosovën, Zvicra është tregu më i madh për nga numri i udhëtarëve (36% më 2023) dhe çmimet e biletave tradicionalisht janë shumë të larta, veçanërisht prej Cyrihut që pas Bazelit është destinacioni i dytë më i shërbyer nga Prishtina.

Të dhënat statistikore tregojnë se nga shteti i Zvicrës deri më tani janë të emëruar pesë (5) operator ajror me flamur të Zvicrës për shërbime ajrore mes Kosovës dhe Zvicrës. Kurse sipas Marrëveshjes dypalëshe midis Kosovës dhe Zvicrës (Neni 5 të Marrëveshjes dhe Neni 2 të MOU) ku janë precizuar kriteret në bazë të të cilave Zvicra në mungesë të operatorit ajror të Kosovës pranon jo më shumë se një (1) operator ajror të huaj që mund të dezignohet nga shteti i Kosovës për ofrimin e shërbimeve ajrore mes dy vendeve.

Kompanitë ajrore Zvicërane që operojnë aktualisht të dezignuara nga Zvicra për shërbimet ajrore për në Kosovë janë: Edelweiss, Swiss International, Easyjet Switzerland dhe Chair Airlines. Destinacionet në të cilat këto kompani fluturojnë nga Prishtina në Zvicër janë aeroportet kryesore ndërkombëtare: Cyrihu, Gjenera dhe Bazeli.

Poashtu aeroporti Basel-Mulhouse që ndahet si territor mes Zvicrës dhe Francës është destinacioni në të cilin kanë fluturuar më së shumti udhëtarë prej Prishtinës gjatë tre viteve të fundit më së shumti

A.B.D

SG

kompani që kanë operuar (24 sosh) kryesisht 'charter' të rregullt që mbulojnë kërkesat e larta për fluturime veçanërisht në sezonat e larta, dhe kjo reflektohet edhe me biletat më të ulta nga ky aeroport kanë operuar. Kompanitë ajrore të BE që fluturojnë prej Prishtinës në Basel-Mulhouse shfrytëzojnë të drejtat e pakufizuara që iu garanton Marrëveshja Evropiane e HPEA/ECAA (HPEA - Hapërirë e përbashkët ajrore) për të bartur udhëtarë nga Prishtina në secilin aeroport të BE. Pra, edhe në këtë rast shumica absolute e udhëtarëve nga ky aeroport për në Kosovë janë nga Zvicra, dhe realisht deri më tani ky ishte aeroporti i vetëm që ka krijuar një konkurrencë në treg karrshi operatorëve tjerë ajror të Zvicrës.

### **Problemi me dezignimin e mëhershëm**

Nga viti 2010 deri në vitin 2024 nga Kosova janë dezignuar operatorë ajror të huaj pa ndonjë proces konkurrimi të hapur përmes ndonjë procedure, dhe pa kritere të përcaktuara.

Kompania ajrore e dezignuar për Kosovën nga 2010 deri 2017 ka qenë Belair. Pas falimentimit të saj më 2017 është hapur mundësia për dezignim të një kompanie tjetër nga BE apo Zvicra, dhe me 2018 operatori ajror gjerman Eurowings së bashku me agjencinë turistike Kosova Airlines ka marrë dezignimin nga Ministria i Infrastrukturës edhe pse dezignimi si proces njih vetëm kompanitë ajrore e jo agjencitë turistike. Në Vendim të dezignimit datë 20.06.2018 (nr. prot. 5836) thuhet se shqyrtimi i kërkesës për dezignim u bë në bazë të kriterëve të përfitimit të publikut, efektit në zhvillimin e aviacionit civil dhe reputacionit të kompanisë, megjithatë nuk ka pasur kritere të prezentuara e as proces të hapur konkurrimi përmes shprehjes së interesit apo ndonjë procedure konkurrimi.

Sipas të dhënave statistikore, edhe pse Eurowings dezignimi iu dha në qershor 2018, fluturimet nuk pati deri në vitin 2019. Që nga viti 2019 e deri në dhjetor 2023 Eurowings ka bartur vetëm rreth 2% të numrit total të udhëtarëve nga Zvicra për në Prishtinë.

Operatori ajror 'Eurowings' bashkë me dy operatorët ajror nga Zvicra 'Edelweiss' dhe 'Swiss' që janë të dezignuara nga shteti i Zvicrës për të ofruar shërbime ajrore në Kosovë që të trija janë kompani në pronësi të Lufthansa Group. Këta operator ajror kanë të drejtë t'i koordinojnë fluturimet dhe kapacitetet e transportit pa rrezikuar të ndiqen nga ligji për shtrembërim të konkurrencës prandaj nuk mund të pritej nga Eurowings të ju bëjë konkurrencë kompanive simotra të të njëjtit pronar në të njëjtin treg. Pra në praktikë deri më tani për shërbime ajrore nga Kosova për në Zvicër dhe anasjelltas kanë operuar Lufthansa Group (përfshirë Eurowings), Chair dhe Easyjet Switzerland, dhe rrjedhimisht nuk ka pasur fare konkurrencë nga operator ajror të dezignuar nga Kosova.

Kjo situatë ka krijuar hapësirë për shtrembërim të konkurrencës ku ka arsye të besohet se agjencitë turistike të Kosovës ('Tour Operators') që i kanë kontraktuar këta operatorë ajror të Zvicrës, në marrëveshje mes tyre i ndajnë kapacitetet e aeroplanëve (ulëset). Në këtë formë krijohet mundësia për tu monopolizuar edhe çmimi i biletave që zakonisht (posaqërisht në sezonat e pushimeve) kanë qenë çmime shumë të larta, deri në 800€ për një biletë kthyesë.

Konkurrenca e vetme domethënëse që mund të shihet nga çmimi i biletave është krijuar me fluturimet e Basel/Mulhouse siç u shpjegua më lartë.

### **Procesi i dhënies së dezignimit dhe kriteret**

Ligji për aviacionin civil nuk ka rregulla për kriteret dhe procedurat se si autoritetet e Kosovës zgjedhin kompaninë që kanë vendosur ta dezignojnë. Zakonisht shtetet dezignojnë kompaninë e tyre flamurtare (flag carrier) dhe pastaj nëse lejohet dezignim i shumëfishtë edhe i kompanive të tjera të tyre. Edhe shteti tjetër palë e Marrëveshjes e bën të njëjtën.

Sipas shpjegimeve të dhëna më lartë, deri më tani, në mungesë të një operatori ajror të shtetit diaspora dhe publiku i Kosovës kanë paguar çmime të biletave shumë më të larta nga Kosova për në vendet Evropiane, më shtrejt se cilatdo destinacione tjera në Evropë. Në këtë situatë, Qeveria e Kosovës në vazhdimësi ka pasur ankesa dhe kërkesa të vazhdueshme nga publiku që të ndikohet dhe të bëhet diçka në këtë fushë.

AP.B.S

SGK

Pas analizimit të situatës, duke mbrojtur parimin e interesit të publikut dhe krijimin e konkurrencës së drejtë, me kërkesë të qeverisë së Kosovës, AAC në kordinim me Ministrinë e Infrastrukturës kanë vendosur që dezignimi i deritanishëm të anulohet, dhe të zhvillohet një proces i ri duke përcaktuar kriteret e domosdoshme që duhet përmbushur operatorët ajror që duan të ofrojnë shërbime ajrore për relacionin Kosovë – Zvicër dhe anasjelltas, kriteret përmes të cilave të arrihet qëllimi i përcaktuar.

Ky proces ka filluar konkretisht me datë 30 Janar 2024 kur AAC ka lëshuar Vendimin 02/ZDP/VE/2024 ku është Revokuar emërimi i operatorit ajror Eurowings ku edhe në arsyetim është shpjeguar se sipas të dhënave statistikore në periudhën 2019-2023 pjesëmarrja e Eurowings GmbH në trafikun e gjithmbarshëm midis Kosovës e Zvicrës ka qenë vetëm 2%.

Vendimi do të fillonte zbatimin për sezonën verore 2024 pasi që Eurowings tashmë kishte të aprovuar fluturimet për sezonin dimëror 2023-2024 që përfundon në fund të Marsit.

Në këtë Vendim është njoftuar poashtu se AAC së shpejti do të publikoj shprehjen e interesit për operatorët ajror të interesuar për marrjen e të drejtave të trafikut ajror në emër të Kosovës, për në dhe nga Zvicra (designation), ku do të përcaktohen dhe publikohen kushte në bazë të të cilave kompanitë ajrore do të mund të shfrytëzojnë autorizimin për ushtrimin e të drejtave të trafikut ajror në emër të Kosovës, për në Kosovë dhe nga Zvicra, në pajtim Marrëveshjen për Shërbime Ajrore në mes të Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Helvetike, dhe në pajtim me Memorandumin për Shërbime të Trafikut të Rregullt Ajror.

Pas këtij vendimi, duke pasur parasysh se Sezona verore e fluturimeve fillon nga muaji Prill, AAC me datë 16 shkurt 2024 ka publikuar Vendimin 03/ZDP/VE/2024 ku është shpallë thirrja publike për shprehje interesi për operatorët ajror të cilët mund të ofrojnë plane fluturimit dhe kapacitete me orar të programuar fluturimesh për të fituar të drejtën e fluturimit përmes emërimit (dezignimit) në destinacionet nga Kosova në Zvicër dhe anasjelltas. Në aneks të vendimit janë prezentuar edhe kriteret e caktuara.

Pra për herë të parë në historinë e Kosovës, ky proces është zhvilluar në mënyrë transparente përmes publikimit të shprehjes së interesit dhe me kriteret të qarta që krijojnë mundësinë për zhvillimin e konkurrencës së drejtë dhe ofrimin e shërbimeve ajrore për publikun me çmime të arsyeshme.

Sipas vendimit shprehja e interesi ishte me afat të shkurtër aplikimi për të arritur organizimin e fluturimeve nga muaji Prill, dhe duke pasë parasysh se aplikonin operatorë ajror që tashmë ishin në treg dhe ishin të njoftuar më heret për këtë proces. Meqenëse interesimi për pjesëmarrje ishte i ulët dhe kishte kërkesa për sqarim të kriterëve, pas shqyrtimit dhe konsultimit bashkë me Ministrinë e linjës është vendosur që të anulohet ai vendim, dhe është bërë shpallja e sërishme me 11 Mars 2024 me afat aplikimi deri më 25 Mars 2024, me synim që të arrihet që fluturimet të fillojnë nga 1 Qershor 2024.

Vlerësimi i dokumentacionit dhe aplikacionet janë bërë nga një komision profesional i përbërë nga zyrtar të AAC dhe të MMPHI (departamenti për transport ajror). Pas procesit të vlerësimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit, operatori i përzgjedhur është publikuar një muaj më pas me datë 24 prill 2024.

Rrjedhimisht, procesi ka filluar me datë 30 Janar me anulimin e vendimit dhe njoftimin për procesin e dezignimit përmes shpalljes për shprehje interesi, pastaj publikimin e shpalljes së interesit me datë 16 Shkurt, e anuluar e më pastaj ri-publikuar me datë 11 Mars, dhe ka përfunduar me datë 24 Prill 2024.

Kompania ajrore e përzgjedhur pas procesit të aprovimit të marrë nga Autoritetet Zvicërene ka arritur të fillojë fluturimet prej datës 24 Qershor 2024.

### **Sqarimi i kriterëve për dezignimin e operatorëve ajror**

Kriteret e përcaktuara janë bërë në përputhje me marrëveshjen bilaterale me shtetin zvicëran, dhe janë kushte kryesore për të siguruar se operatorët ajror do të realizojnë objektivat e qeverisë së Kosovës

U.B.D

SGK

dhe AAC për të ofruar një transporti ajror të sigurtë dhe të qëndrueshëm si dhe konkurrencë të drejtë e me çmime të arsyeshme të tregut për publikun e Kosovës dhe atë të Zvicrës.

Kriteret janë ndarë në tri fusha si në vijim:

- 1 - Operimi i biznesit,
- 2 - Kriteret e performancës për kapacitetet operationale dhe shërbimet e operatorit ajror, dhe
- 3 - Frekuenca e fluturimeve.

### **1 - Operimi i biznesit**

- Regjistrimi i biznesit në Kosovë konsiderohet interes edhe ekonomik dhe mundëson kontrollin më të lehtë dhe afarizmin direkt në Kosovë, punësimin e publikut, etj.. Ky kusht ka nënkuptuar që aplikuesit duhet të bëjë regjistrimin e biznesit nëse kanë interesim të operojnë si kompani e dezignuar dhe jo domosdoshmërisht të kenë të regjistruar biznesin më heret.
- Kriteri që ka të bëjë me Certifikatën e Operimit Ajror (COA) dhe COA dhe Licencë Operimi (LO) nga një shtet anëtar i BE-së ose Zvicrës është kriter i standardeve të sigurisë së operimit, një kusht bazik edhe sipas marrëveshjes bilaterale me shtetin Zvicëran.
- Kriteri në lidhje me kufizimin për partneritet apo në pronësi pjesërisht ose plotësisht të operatorëve ajror dhe/ose pronarëve të tyre që mbajnë një COA dhe Licencë Operimi (LO) nga Zvicra dhe që janë të autorizuar të kryejnë shërbime ajrore nga shteti i Zvicrës për në Kosovë dhe anasjelltas, është kriter i domosdoshëm që siguron konkurrencë të njëmendtë e të drejtë, dhe kufizon mundësinë që vetëm operatorët ajror të Zvicrës të kenë qasje e kontrollë tregun e shërbimeve ajrore. Pa këtë kusht, dezignimi nuk ka kuptim sepse operatorët ajror të Zvicrës tashmë kanë dezignimin nga shteti i Zvicrës për flururime në mes të dy shteteve, dhe kjo nuk mund të bëhet nga të dyja shtetet.
- Bilanci pozitiv financiar i operatorëve ajror është një kriter që siguron se në garë hyjnë kompani me stabilitet financiar dhe qëndrueshmëri të operimeve gjatë ofrimit të shërbimeve për publikun e Kosovës. Kurse garancioni bankar është një kriter që e forcon kontrollin e shtetit ndaj operatorit ajror për të përmbushur zotimet e dhëna, si i vetmi mekanizëm detyrues i mundshëm për momentin.

Publiku kosovar është ballafaquar pothuajse çdo vit me situata kur operator ajror të papërgjegjshëm kanë lënë udhëtarë në aeroport duke mos realizuar fluturimet sipas biletave të paguara, dhe kemi pasur edhe rastin më të rëndë në 2018 me BelAir kur pas bankrotimit me qindra udhëtarë nga Kosova e mijëra nga Shqipëria me bileta të paguara kanë mbetur pa udhëtuar.

### **2 - Kriteret e performancës për kapacitetet operationale dhe shërbimet e operatorit ajror**

- Kushti për të mundësuar konkurimin për operatorët ajror që kanë operuar me performancë pozitive me së paku 100.000 pasagjerë për/nga ANP "Adem Jashari" gjatë vitit paraprak (2023) ka për qëllim të sigurohet se në garë hyjnë operatorë ajror që tashmë kanë dëshmuar performancë të mirë në tregun e shërbimeve ajrore në Kosovë. Futja e ndonjë operatori ajror të panjohur që mund të japin oferta atraktive sa për të fituar të drejtën dhe shfrytëzimin p.sh. vetëm për sezonën verore ku ndërkohë dështojnë, nuk e vazhdojnë me fluturime dhe largohen mund të krijojë pasoja të mëdha duke ç'rregulluar tregun dhe të krijojnë situatë edhe më të rëndë se tani. Ky kusht siguron një vazhdimësi të performancë së mirë dhe është poashtu kriter parimor ku ju ipet përparësi operatorëve ajror që tashmë kanë rrjet të klientëve dhe mund të hyjnë në tregun e Zvicrës dhe mund të performojnë më lehtë dhe më sigurtë duke arritur objektivin e synuar që është konkurenca e drejtë me çmime të arsyeshme.

- Kushtet minimale për kapacitetin nevojshëm të flotës së mjeteve ajrore dhe ekuipazhit (në dispozicion se paku 3 aeroplana me kapacitet së paku 150 ulëse) ka për qëllim të sigurojë se operatori ajror ka të mbuluar kapacitetet e duhura për një performancë të mirë gjatë operimeve, përfshirë edhe organizimin e mirëmbajtjes në rast të ndonjë intervenimi, dhe të evitohen situata kur mbeten udhëtarë në aeroport duke pritur me orë të tëra apo anulime të fluturimeve. Ky kusht nuk kërkon që ofruesit të kenë në pronësi këto kapacitete, por të kenë në dispozicion që len mundësinë edhe për marrjen e aeroplanëve me qera sipas nevojës, rregull që është në përputhje me Rregulloren Evropiane për të drejtat e fluturimit që aplikohet edhe nga Kosova edhe nga Zvicra.
- Poashtu kushti për shitjen e shërbimeve ajrore në Zvicër dhe Kosovë edhe përmes kanaleve/shërbimeve direkte tek konsumatori kufizon mundësinë që publiku të mashtrohet apo manipulohet nga stërshitës të biletave të pakontrolluar me çmime të larta.
- Kushti për ofrimin e udhëzimeve në aeroplan në gjuhën shqipe është kërkesë e vazhdueshme e publikut sepse shumë qytetar nuk flasin gjuhët e huaja, dhe kjo përveqse është një e drejtë elementare për qytetarët, ka të bëjë edhe me komoditetin e tyre gjatë udhëtimit, e poashtu edhe sigurinë sepse qytetarët që nuk janë në gjendje të kuptojnë udhëzimet e dhëna nga ekuipazhi në gjuhë të huaja në rastet emergjente ndikon të rrezikohet jeta e tyre.
- Kriteri për të mundësuar shkollimin e ekuipazhit për shtetasit e Kosovës është një mundësi me përfitim reciprok edhe për operatorin ajror edhe për shtetasit e Kosovës. Kjo mundëson punësimin e shtetasve të Kosovës me ndikim pozitiv edhe në ekonominë e shtetit e në anën tjetër edhe operatori ajror mund të punësojë personel kosovar me kosto më të lirë.

### 3 - Frekuenca e fluturimeve

- Kriteret për frekuencat minimale javore dhe vjetore të fluturimeve si dhe shfrytëzimin e kapacitetit të ulëseve (load factor) janë bërë duke u bazuar në të dhënat statistikore të fluturimeve të viteve të mëhershme në ANP “Adem Jashari”, si kriteret esenciale të nevojshme për të siguruar rritjen e konkurrencës së drejtë dhe uljen e çmimeve për shërbime ajrore. Pra, kriteret janë dhënë bazuar në numrat minimal të frekuencës së fluturimeve për tu siguruar edhe ofrimi i shërbimeve të rregullta ajrore por edhe një qëndrueshmëri të biznesit në raport me kërkesat e tregut. Megjithatë, është lënë mundësia dhe hapësira që operatorët ajror të ofrojnë numër edhe më të madh të fluturimeve sipas analizës dhe planit të tyre të biznesit.
- Kriteri për shfrytëzimin e kapacitetit të ulëseve (load factor) me 90% në ndërlidhje me kushtin e përmbushjes minimale të detyrimeve të përgjithshme për frekuencat e fluturimeve (90%) bie të jetë minimum 81% që poashtu është mesatarja e kapacitetit të shfrytëzuar (load factor) sipas statistikave të fluturimeve në ANP “Adem Jashari” për vitin paraprak 2023. Ky kriter siguron se operatori ajror nuk krijon çmime artificialisht të larta, pra duke u detyruar të mbushë aeroplanin me udhëtar dhe të shes biletat sipas kërkesës së tregut, dhe krijimin e një konkurrence më të madhe edhe me operatorët e tjerë.

### Analiza e Konkurrencës

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, ka mandat identifikimin e marrëveshjeve të ndaluara (kartelet), përcaktimin e pozitës dominuese dhe keqpërdorimin e saj, me të cilat përcaktohen masat, kushtet dhe afatet për eliminimin e efekteve të dëmshme, dhe ndalimin e çdo sjelljeje të mëtejshme që çon në marrëveshje të ndaluar,

keqpërdorim i pozitës dominuese, si dhe vlerësimi ex-ante i ndërmarrjeve në proces të përqendrimeve, në bazë të analizave të hollësishme ligjore dhe ekonomike sipas procedurave ligjore.

Parimi themelor i ligjit dhe politikës së konkurrencës është të sigurojë qasje në treg të lirë, për çdo ndërmarrje e cila i plotëson kushtet për të konkurruar në atë treg në interes të përdoruesve të shërbimeve dhe të mund të konkurrojë me çmim dhe cilësi.

Objektivi kryesor i politikës së konkurrencës është ruajtja e procesit konkurrues dhe nxitja e konkurrencës efektive në treg. Ruajtja ose nxitja e konkurrencës efektive është e domosdoshme, duke pasur parasysh kufizimet që sektori privat apo ai shtetëror/publik mund t'i bëjnë konkurrencës.

Autoriteti kryen detyrat si një organi i pavarur për mbrojtjen e konkurrencës, në të gjitha tregjet ekskluzivisht brenda fushëveprimit dhe kompetencave të përcaktuara nga Ligji Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës zhvillimin e procedurës e bazon në neni 35 – Propozimi për Fillimin i Procedurës dhe ex-officio neni 36 - Fillimi i Procedurës, dhe atë në rastet kur kemi të bëjmë me të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës nga ana e ndërmarrjeve që operojnë në tregjet përkatëse. Neni 3 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës bën përkufizimin e definicionit të ndërmarrjes sipas të drejtës së konkurrencës, si vijon: “Ndërmarrje - çdo person fizik ose juridik, privat ose publik, i angazhuar në veprimtari ekonomike, pavarësisht statusit juridik dhe mënyrës së financimit. Organi publik quhet ndërmarrje nëse angazhohet në veprimtari ekonomike”.

Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës sipas politikës së konkurrencës në rastin konkret bazuar në veprimtarinë e saj, nuk konsiderohet ndërmarrje në kuptim të nenit 3 paragrafët 10 dhe 12 të Ligjit Nr. 08/L056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, për shkak se nuk kryen aktivitet ekonomik dhe si rrjedhojë nuk operon në treg, përmes blerjes së mallrave ose shërbimeve, për shkak se përdorimi pasues i mallrave ose shërbimeve në rastin konkret nuk përbën veprimtari ekonomike.

Autoriteti i Konkurrencës konsideron se, Autoriteti i Aviacionit Civil nuk është ndërmarrje për faktin se Ligji Nr. 03/L-051, për Aviacionin Civil neni 14 paragrafi 14.1 potencon se: Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës (“AAC”) themelohet me këtë ligj, si agjenci e pavarur rregullatorë. AAC është përgjegjëse për rregullimin e sigurisë së aviacionit civil dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe shërbimeve të navigimit ajror në Republikën e Kosovës. AAC ka kapacitet të plotë juridik. AAC është organizatë buxhetore dhe autoritet publik dhe i nënshtrohet dispozitave përkatëse mbi organizatat buxhetore dhe autoritetet publike në ligjet dhe aktet e tjera ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

Kushtet e shpalljes publike për shprehjen e interesi për operatorët ajrorë shpallura nga Autoriteti i Aviacionit Civil, të cilat në thelb kanë të bëjnë me të drejtën për të marrë pjesë, përkatësisht me kushtet e aftësisë së konkurrentëve, zbatimi dhe interpretimi i të cilave nuk është brenda kompetencës dhe fushëveprimit të AKRK-së, është çështje e mbikëqyrjes në kompetencë të organeve të administratës shtetërore/qendrore si institucione zbatuese dhe mbikëqyrëse të prokurimit publik siç janë: Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP) dhe Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), bazuar në rregullore dhe ligje të veçanta, në rastin konkret Ligji Nr. 04/L- 042 për Prokurim Publik.

Autoriteti në rastin konkret, nuk është kompetent për zbatimin e ligjeve të veçanta, por aspekti ligjor dhe rregullativ është në kompetencë të rregullatorëve të tjerë sektorialë, e në këtë rast, Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës.

U.P.B.D

SGK



Nga sa më lartë, Komisioni i Autoritetit duke u bazuar në nenin 55 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, u vendos si në dispozitiv të këtij Konkluzioni.

Obligohet Sekretariati që të kujdeset për zbatimin e këtij konkluzioni.

Ky konkluzion, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana Komisionit.

**AUTORITETI I KONKURENCËS**  
**Komisioni**

**Neime Binaku Isufi**  
Kryetare

**Kaltrina Sela**  
Nënkryetare

**Florent Mehmeti**  
Anëtar

**Nafije Osdautaj**  
Anëtare

**Salihe Gashi Loku**  
Anëtare

**Këshilla juridike:** Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa, por pala me padë mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.

Me këtë KONKLuzion të njoftohen:

- Paraqitësi i Iniciativës
- Publikohet në web faqen e Autoritetit
- Arkiva